



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 06.04.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:25.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

*10. Erjon Muharremaj* (anëtar)

*11. Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 6 prill 2020 fillon me prezantimin e pikës së rendit të ditës nga Kryetarja së Këshillit, zonja Naureda Llagami.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin e parë shpjegues lidhur me radhën e procedurave të shortit sipas gjykatave si më poshtë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë;

Gjykata e Apelit Gjirokastrë.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2 (një për një çështje dhe një për çështjen tjetër).

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti i çështjes nr. 1, gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, që është caktuar më herët për gjykimin e kësaj çështje, konkretisht: z. Artan Çupi.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Rexhep Karaj, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë nr. 1 dhe gjyqtari Murat Lleshi, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë nr. 2, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2 (një për një çështje dhe një për çështjen tjetër).

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: z. Petrit Çomo. Gjithashtu të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: z. Bedri Qori; z. Kreshnik Omari; z. Kastriot Gramshi; znj. Shefkije Demiraj; znj. Ardiana Bera; znj. Migena Laska.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtari Ahmet Metaliaj, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë nr. 1 dhe gjyqtari Arben Micko, i cili caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë nr. 2, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht: z. Markelian Koça.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Eda Kaja, e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti

Kryetarja në detyrë i Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit janë dakord me këto propozime të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen gjyqtarët Petrit Aliaj (relator), Skënder Damini dhe Margarita Buhali (anëtarë), të cilët caktohen për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Pas përfundimit të hedhjes së shortit, **zoti Alban Toro** merr fjalën dhe propozon që të diskutohet çështja e pezullimit të veprimtarisë së gjykatave, duke qenë se aktualisht ato janë të pezulluara deri në datën 7 prill. Zoti Toro propozon që të caktohet një datë për shtyrjen e afatit. Gjithashtu edhe **zonja Marçela Shehu** e mbështet këtë propozim duke menduar për një afat dyjavor për shtyrjen e veprimtarisë në gjykata. Në mbështetje të kësaj, edhe **zoti Dritan Hallunaj** është dakord për një shtyrje dyjavore.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 06.04.2020)*

**Pika 2 shtesë e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:00 dhe mbaroi në orën 14:25.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**

#### **RENDI I DITËS:**

2 (shtesë). Shqyrtimi i projektvendimit “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”.

Pas përfundimit të hedhjes së shortit të pikës së parë, **zoti Alban Toro** merr fjalën dhe propozon që të diskutohet çështja e pezullimit të veprimtarisë së gjykatave, duke qenë se aktualisht ato janë të pezulluara deri në datën 7 prill. Zoti Toro propozon që të caktohet një datë për shtyrjen e afatit. Gjithashtu edhe **zonja Marçela Shehu** e mbështet këtë propozim duke menduar për një afat dyjavor për shtyrjen e veprimtarisë në gjykata. Në mbështetje të kësaj, edhe **zoti Dritan Hallunaj** është dakord për një shtyrje dyjavore.

Duke qenë se disa nga anëtarët janë dakord që të shprehen me votim për këtë çështje, atëherë hidhet në votim propozimi për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni i përhapur Covid-19. Rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.  
Erjon Muharremaj është dakord.  
Brikena Ukperaj është dakord.  
Medi Bici është dakord.  
Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi miratimin e projekt-aktit “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” dhe kohëzgjatja e pezullimit të jetë për një periudhë 2 (dy) javore duke filluar nga data 08.04.2020 deri më datë 22.04.2020.

Me këtë çështje të rendit të ditës përfundon mbledhja e datës 06.04.2020.

\* \* \*

(Pika 2 shtesë e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**